



St Josephine Bakhita

Lindur: 1869 në Darfur, Sudan

Vdekur: 8 shkurt 1947 në Itali

Josephine Bakhita u lind në vitin 1869 në Dafur, Sudan. Në moshën shtatë vjeçare, ajo u rrëmbye nga trafikantët arabë të skllëvërve dhe në 8 vitet në vazhdim u shit dhe u rishit 5 herë. Ajo ishte aq e traumatizuar nga rrëmbyesit, sa që nuk mbante mend as emrin e saj. Rrëmbyesit e quajtën atë “Bakhita”, që do të thotë “Njeri me shumë fat”.

Pronari i saj i fundit, konsulli Italian, e solli atë në Itali si dado për vajzën e tij. Kur familja duhet të udhëtonte për punë, e linte Bakhitën dhe vajzën nën kujdesin e Motrave Kanosiane të Insitutit të Katekumenëve në Venecia. Atje, ajo njohu dhe përjetoj dashurinë e Zotit.

Në vitin 1890, Bakhita kërkoi të pagëzohej dhe të quhej Josephine. Kur familja u kthye të merrte vajzën dhe Bakhitën, Josephine rezistoi dhe çështja e saj shkoi në gjykatë, e cila mbështeti lirinë e saj, duke qënë se skllavëria nuk ishte e njohur nga ligji Italian.

Në vitin 1896 ajo mori votat si motër Kanosiane dhe për 50 vitet në vijim ajo bëri një jetë të thjeshtë, me besim dhe shërbime (veçanërisht si portiere në konventë), duke treguar dashamirësi për këdo, veçanërisht për fëmijët e rrugës.

Në vitet e fundit të jetës së saj, ajo vuajti nga sëmundje dhe kujtimet që e përndiqnin mbi kohën e skllavërisë, me rrahje dhe fshikullime me kamzhik. Josephine Bakhita u nda nga jeta në vitin 1947 dhe në vitin 2000 u kanonizua. Ajo ishte Sudanezja e parë që u shpall e Shenjtë.

St Josephine Bakhita: Lutu për ne!

Në qoftëse ju keni nevojë për ndihmë ose njihni dikë që ka nevojë për ndihmë mund të telefononi në këtë numër falas:

11 60 06

**DITA NDËRKOMBËTARE
E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E LUTJES
KUNDËR TRAFIKIMIT
TË PERSONAVE**

DITA E SHËN BAKHITA

8 SHKURT 2018



MIGRIM PA TRAFIKIM

Thuaji PO Lirise dhe JO Skllaverise

O Zot, kur dëgjojmë që fëmijë dhe të rritur mashtrohen dhe dërgohen në vende të panjohura me qëllim shfrytëzimi seksual, pune të detyruar dhe “vjelje” organesh, zemrat tona trishtohen dhe shpirtrat tonë trazohen, pasi dinjiteti dhe të drejtat e tyre nëpërkëmben përmes kërcënimeve, gënjeshtreve dhe forcës.

Ne bërtasim kundër praktikës mizore të skllavërisë moderne dhe lutemi me Shën Bakhitan që kjo të marrë fund. Na jep neve urtësi dhe kurajë që të arrijmë dhe qëndrojmë me ata, trupat, zemrat dhe shpirtrat e të cilëve janë plagosur kaq shumë, kështu që së bashku ne mund të bëjmë realitet premtimet Tua për të mbushur këta motra dhe vëllezër me dashuri, e cila është e ëmbël dhe e mirë.

Largoi shfrytëzuesit duarbosh dhe të çlirohesh nga kjo ligësi, dhe na ndihmo ne të gjithëve që të kërkojmë lirinë e cila është dhurata jote për fëmijët e Tu. **Amen**



Në qoftëse ju keni nevojë për ndihmë ose njihni dikë që ka nevojë për ndihmë mund të telefononi në këtë numër falas:

11 60 06